



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.1530 datë 18.03. 2011**

**Për**

**“Disa amendime në Rregulloren e Portabilitetit të Numrit Nr.13 datë 16.04.2010”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 18.03.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brëndshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Miratimin e “Disa amendime në Rregulloren e Portabilitetit të Numrit Nr.13 datë 16.04.2010”

**BAZA LIGJORE:**

1. Nenet 87 dhe 88 të ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”(ligji 9918).
2. Rregullore “Për Portabilitetin e Numrit” Nr.13 datë 16.04.2010.
3. Nenet 1, 2, 106 e në vijim të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (ligji nr. 8485), i ndryshuar;
4. Pika 1, germa (e) dhe pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish

ERT)” (Rregullorja e Brendshme), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Projekt vendimi
- Relacioni Shoqërues i projekt vendimit

### **V Ë R E N:**

1. AKEP, në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i rregullores së Portabilitetit të Numrit, ka konstatuar disa problematika që kanë dale me operatorët për implementimin e saj.

Sipas edhe kërkesës së operatorëve, por edhe sipas praktikave të ndryshme, në zbatimin e këtij procesi, del e nevojshme disa ndryshime në lidhje me detyrimet e operatorëve për kryerjen e njoftimit për pajtimtarët, përpara se të thirret një numër i bartur

2. Hartimin e nje beep tone, (lajmerues të bartjes) i cili të jetë i njëjtë për të gjithë operatorët e të mos krijojë konfuzion tek pajtimtarët.

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Bazuar në pikën 1 të nenin 114, dhe pikën 1 të nenit 115 të ligjit nr. 9918, si dhe pika 17, neni 21 të Rregullores së Brendëshme te AKEP, e ndryshuar,

### **V E N D O S:**

Në rregulloren për Portabilitetin e Numrit Nr. 13 datë 16.04.2010, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 5 e nenit 6 anulohet.
2. Në neni 7 shtohet neni 7/1 si më poshtë:

NENI 7/1

Njoftimi i numrit të bartur

Operatorët janë të detyruar t'i njoftojnë nëpërmjet nje mesazhi zanor në formën beep tone, pajtimtarëve të tyre, bartjen e numrit, përpara kryerjes së thirrjes drejt numrave të bartur.

Beep tone do të jetë i njëjtë për të gjithë operatorët e do të shërbejë për të njoftuar pajtimtarët se numri është bartur

3. Formulari i kërkesës për bartje sipas shtojcës bashkëngjitur këtij vendimi.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**Piro XHIXHO**

**ANËTARË:**

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**

## Kërkesa për bartjen e numrit/numrave

Numri/numrat e telefonit që do të barten:  ..... Seritë e numrave që do të barten;  Nga.....deri;.....
Emri i pajtimitarit:
Data e lindjes ose (ID) (nëse pajtimitari është individ):
Numri NIPT (nëse pajtimitari është i regjistruar):
Numri i telefonit do të bartet nga rrjeti i (“operatori dhënës”):
Numri i telefonit do të bartet në rrjetin e (“operatori marrës”):
Data kur do të bëhet bartja: Brenda 3 diteve pune  _____ . _____ . _____ data, muaji, viti

Unë, i nënshkruari, jam informuar si më poshtë:

- a) Bartje e një numri/numrave të telefonit do të thotë që numri/numrat e plotë (duke përfshirë edhe tri shifrat e para) transferohet nga rrjeti i një operatori (“operatori dhënës”) në rrjetin e një operatori tjetër (“operatori marrës”). Si pajtimtar i një shërbimi telefonik kam të drejtën të kërkoj bartjen dhe që të dy, operatori i vjetër dhe i riu janë të detyruar të mbështesin këtë proces. Pajtimtari kërkon bartjen nëpërmjet nënshkrimit të këtij dokumenti dhe paraqitjes së tij tek operatori marrës, i cili duhet ti ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të bartur numrin/numrat.
- b) Kontrata ime ekzistuese me operatorin dhënës do të përfundojë në kohën kur bartja bëhet efektive, por bartja nuk do të përfundojë detyrimet ekzistuese kontraktore.
- c) Në veçanti, unë duhet ti paguaj operatorit dhënës të gjitha detyrimet e papaguara që dalin nga kontrata ime ekzistuese. Kjo mund të përfshijë tarifën për portabilitetin e numrit

dhe/ose kompensimin nëse unë e anuloj kontratën para kohëzgjatjes minimale të kontratës të rënë dakord.

- d) Nëse kam ndonjë pyetje lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara dhe ndonjë pagesë tjetër të mundshme ndaj operatorit dhënës, këto çështje duhet ti sqaroj në kontakt të drejtpërdrejtë me operatorin dhënës para nënshkrimit të këtij dokumenti.
- e) Operatori marrës është i detyruar të më informojë lidhur me detajet e kushteve të kontratës sime të re, në veçanti lidhur me çdo detyrim që unë duhet ti paguaj operatorit marrës dhe nëse une mund të përdor pajisjet ekzistuese në rrjetin e operatorit marrës.
- f) Nëse kam ndonjë pyetje tjetër lidhur me kushtet ose tarifat e kontratës së re, do ti sqaroj këto çështje në kontakt të drejtpërdrejtë me operatorin marrës para nënshkrimit të këtij dokumenti.

Deklaroj si më poshtë:

1. Aktualisht përdor numrin/numrat e përmendur të telefonit në rrjetin e operatorit dhënës dhe dëshiroj të anuloj kontratën me operatorin dhënës.
2. Dëshiroj të nënshkruaj kontratë me operatorin marrës sipas kushteve kontraktore, kushteve dhe tarifave të përgjithshme të biznesit të cilat më janë paraqitur nga operatorin marrës në dokumente të veçanta.
3. Dëshiroj që të dy operatorët të bashkëpunojnë dhe të bartin numrin/numrat e përmendur nga rrjeti i operatorit dhënës në rrjetin e operatorit marrës në kohën e kërkuar. Autorizoj operatorin marrës, që në emrin tim, të ri-drejtojë kërkesën time operatorit dhënës për anulimin e kontratës time ekzistuese.

---

(Vendi dhe data)

---

(Nënshkrimi)